

VENDIM
Nr. 242, datë 30.3.2016

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 10.12.2015, PËR ÇËSHTJEN “ARTAN LAKO KUNDËR SHQIPËRISË DHE DY APLIKIME TË TJERA” (APLIKIMET NR. 48693/08, NR. 72462/11, NR. 30946/12)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46, të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, “Për buxhetin e vitit 2016”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 10.12.2015, për çështjen “Artan Lako kundër Shqipërisë dhe dy aplikime të tjera”, në shumën 1 200 (një mijë e dyqind) euro për kërkesin Artan Lako (aplikimi nr. 48693/08); në shumën 900 (nëntëqind) euro për kërkesin Bardhyl Ibra (aplikimi nr. 72462/11); në shumën 1 400 (një mijë e katërqind) euro për kërkesën Gerta Xhaferi (aplikimi nr. 30946/12), në lidhje me dëmin pasuror dhe jopasuror, kostot dhe shpenzimet, duke i përjashtuar nga çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës ku do të depozitohen shumat, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Shumat e përcaktuara si detyrim në pikën 1 të këtij vendimi, të depozitohet në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të aplikantëve z. Artan Lako, z. Bardhyl Ibra, znj. Gerta Xhaferi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 17.11.2015, për çështjen “Artan Lako kundër Shqipërisë dhe dy aplikime të tjera”, bërë përfundimtar në datën 10.12.2015.

4. Pagesa e shumës së depozituar, sipas pikës 3 të këtij vendimi, në favor të aplikantëve, të bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor të nevojshëm për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor, nga dita kur vendimi i Gjykatës është bërë përfundimtar.

5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4 të këtij vendimi, mbi shumën e mësipërme paguhen interesa të thjeshta, të barabarta me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus 3 (tre) për qind.

6. Efekti financiar, i parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi i kontingjencës i buxhetit të shtetit.

7. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama